



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.499/5 prot.

Datë 26.04.2022

V E N D I M

Nr. 381/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.04.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-16943-01-07-2022, me objekt: “Loti I – “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond të marrëveshjes kuadër: 132,776,585 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.02.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK.

Ankimues:

“Sori-Al” SHPK
Rruga Beqir Luga, Pallati nr.3, shk.1/1 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Blv “Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

Subjekt i Interesuar:

Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK
Rruga “Bardhok Biba”, Pallati TREMA, Hyrja C,
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.01.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-16943-01-07-2022, me objekt: “*Loti I – “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Spitalin Universitar të*

Traumës”, me fond të marrëveshjes kuadër: 132,776,585 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.02.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 09.02.2022 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 01.03.2022 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- | | | |
|-------------------|----------------|----------------|
| - Dajti Park 2007 | 102,801,600 | I kualifikuar |
| - Sori –Al | 128,790,026.28 | I skualifikuar |

II.4. Në datën 01.03.2022 operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

- OE “Sori-Al” SHPK, nuk plotëson pikën 1, seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatoreve ekonomike” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në SPE ka deklaruar vetëm 4 (kater) vende të ushtrimit të aktivitetit (stabilimente) për të cilat ka paraqitur edhe 4 licencat përkatëse. Nderkohe që, nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar të subjektit rezulton se, ky i fundit ka 9 (nente) vende të ushtrimit të aktivitetit (stabilimente). Pra, Ofertuesi nuk ka deklaruar 5 (pese) vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit (stabilimentet), dhe konkretisht stabilimentet në: Spitalin Ushtarak Universitar Tirane; brenda ambienteve të Qendres së Formimit Policor, Sauk, Tirane; në Rrugën “Mitaq Sallata”, Lagjja Partizani (98,32 km) 9401, brenda ambienteve të spitalit Rajonal Vlore; Brenda ambienteve të Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, Sauk TIRANE dhe në Rr “Daullas Grecalli” nr.17, Daullas, brenda ambienteve të Spitalit Rajonal Memorial Fier; të cilat nuk rezultojnë të jenë të pajisura me licencat përkatëse për ushtrimin e aktivitetit sipas ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, neni 19.

II.5. Në datën 03.03.2022 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e **Njoftim-Fituesit** në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 10.03.2022, operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, me pretendimet si më poshtë:

1. Në kriteret e përzgjedhjes është përcaktuar saktësisht nga ana e autoritetit kontraktor se ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë për çdo stabiliment që operatori disponon të cilin duhet ta ketë në pronësi/me qira dhe për të cilën duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse sipas parashikimeve të ligjit nr.9863 datë 28.01.2008 Për ushqimin. Shoqëria Sori Al ka paraqitur deklaratën për ambientet në disponim datë 09.02.2022 në të cilën ka deklaruar stabilimentet e saj të cilat i ka në pronësi dhe me qira të pajisura me licencat përkatëse.

2. *Rruga e Dibrës Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes Tiranë ; Qira; LN-0308-09-2009*
3. *Brenda ambienteve të spitalit psikiatrik Ali Mihali Lagjja 10 Korriku Rruga Perlat Rexhepi Vlorë; Qira; LN-2369-11-2016*
4. *Spitali rajonal Berat; Qira; LN-9898-07-2015*
5. *Rruga Kongresi i Manastirit ; Në pronësi; LN-2896-03-2017.*

Stabilimentet e sipërpërmendura janë të vetmet struktura për të cilat shoqëria Sori AL ShPK ka nënshkruar kontratat përkatëse të Qerasë me palën qiradhënëse si dhe është pajisur me Certifikatë për Vërtetim Pronësie nga organet kompetente të cilat i ka deklaruar sipas kërkesave të DT.

Në lidhje me arsyen e skualifikimit sqarojmë se AK në asnjë moment nuk ka kërkuar që operatorët ekonomikë të deklarojnë të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas QKR. Është e papranueshme arsyeja e skualifikimit pasi edhe vetë AKU nuk të lejon që të disponosh stabiliment në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi. Shoqëria Sori-AL në 5 adresat e tjera sekondare për të cilat AK pretendon se nuk janë deklaruar nuk disponon ambient me qira ose në pronësi pasi në këto adresa shoqëria Sori Al ShPK bën vetëm shpërndarjen e ushqimit të gatuar sipas parashikimeve në kontratat e shërbimit të nënshkruara me palët kontraktore.

Sikundër evidentohet nga kontratat e shërbimit shoqëria Sori Al ShPK nuk disponon as në pronësi dhe as me qira asnjë stabiliment në adresat sekondare dhe se në këto adresa sekondare shoqëria ushtron vetëm shërbimin e shpërndarjes së ushqimit dhe jo të gatimit pasi gatimi i ushqimit bëhet në stabilimentet që shoqëria jonë ka deklaruar në këtë procedurë prokurimi për të cilat ka nënshkruar kontrata qiraje dhe është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie si dhe me licencat përkatëse. Nga ana e KVO mund të verifikohej lehtësisht nëse shoqëria Sori Al ShPK disponon apo jo ambient me qira në adresat e sipërpërmendura.

Termi Stabiliment sipas fjalorit të gjuhës shqipe do të thotë Një ose disa ndërtesa të pajisura me mjetet e duhura për të punuar a prodhuar diçka.... Referuar këtij përcaktimi për të disponuar një stabiliment duhet që të ushtrosh një veprimtari prodhimi e cila në rastin e shërbimit objekt i kësaj procedure do të referohej prodhimit/punimit të ushqimit.

Sa më sipër pretendimet e KVO për skualifikimin e shoqërisë Sori Al ShPK nuk qëndrojnë.

2. *Në lidhje me kualifikimin e shoqërisë Dajti Park 2007 ShPK sqarojmë se kjo shoqëri ka parregullsi dokumentacioni të domosdoshëm për kualifikim si më poshtë:*
 - *Referuar shtojcës 8 kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të DT kërkohet dorëzimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9. Plotësimi i kësaj shtojce nuk është bërë konform kërkesave të DT pasi nuk janë plotësuar të dhënat për të dy ortakët dhe administratorin e shoqërisë (Z.D.K dhe Z.L.Q) sipas formatit të kërkuar si dhe nuk janë deklaruar makineritë dhe mjetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës.*

- *OE Dajti Park 2007 nuk ka deklaruar stabilimentet që disponon sipas kërkesës së seksionit 2 kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1.kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë. Referuar Buletineve të njoftimeve publike rezulton që shoqëria Dajti Park 2007 është shpallur fituese në disa procedura prokurimi. Duke ju referuar ekstraktit të shoqërisë i vetmi vend i ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë (veç selisë) është vetëm adresa sekondare Tiranë Dajti Priskë e madhe Dajti Park). Mosdeklarimi i adresave të tjera sekondare në të cilat OE ushtron aktivitet është shkelje e legjislacionit tatimor tregtar dhe ushqimor, pasi OE nuk ka deklaruar një vend të ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar. OE nuk ka deklaruar punonjësit të cilët ka vendosur në dispozicion për kryerjen e shërbimit. Nga ana tjetër mosplotësimi i këtyre kriterëve ligjore të domosdoshme gjatë kryerjes së shërbimeve të marra përsipër nga OE Dajti Park 2007 passjell edhe deklarim të rremë nga ky OE lidhur me deklaratën për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës.*
- *Operatori ekonomik dajti Park 2007 ka dështuar në dorëzimin e plotë ligjor të dokumentacionit për të vërtetuar se disponon ambient ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit sipas kërkesave të nënpikës 2 të pikës 2.3 kapaciteti teknik të DT. OE nuk ka dorëzuar gjithashtu deklaratën për plotësimin e standardeve tekniko- teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.*
- *OE Dajti park 2007 ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për secilin nga punonjësit sipas pikës 4 të kapacitetit teknik të DT pasi nuk ka dorëzuar deklaratat e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale për drejtuesin teknik, për kuzhinierët dhe për ndihmës kuzhinierët. Gjithashtu OE nuk ka dorëzuar deklaratën në të cilën merr përsipër që për zbatimin e kësaj kontrate stafi i paraqitur nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera deri në përfundim të kontratës.*
Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë Sori Al ShPK
Skualifikimin e shoqërisë Dajti Park 2007 ShPK.
Marrjen e masave ndaj anëtarëve të KVO sipas nenit 132 Kundërvajtje Administrative pika 1 shkronja gj dhe pika 3 e ligjit 162/2020 Për prokurimin publik.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.499/2 prot datë 11.03.2022 me arsyet e skualifikimit të ankimuesit si dhe me kriteret të cilat ankimuesi pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik Dajti Park 2007.

II.8. Me shkresën nr. 486 prot, datë 24.03.2022, protokolluar me tonën me nr. 499/3 prot datë 25.03.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së

operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Sori Al” SHPK, ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “Dajti Park 2007” SHPK nuk ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sori Al” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se OE “Sori-Al” SHPK, *nuk plotëson pikën 1, seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatoreve ekonomike” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në SPE ka deklaruar vetëm 4 (kater) vende të ushtrimit të aktivitetit (stabilimente) për të cilat ka paraqitur edhe 4 licencat perkatëse. Nderkohe që, nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar të subjektit rezulton se, ky i fundit ka 9 (nente) vende të ushtrimit të aktivitetit (stabilimentet). Pra, Ofertuesi nuk ka deklaruar 5 (pese) vendet e tjera të ushtrimit të aktivitetit (stabilimentet), dhe konkretisht stabilimentet në: Spitalin Ushtarak Universitar Tirane; brenda ambienteve të Qendres së Formimit Policor, Sauk, Tirane; në Rrugën “Mitaq Sallata”, Lagjia Partizani (98,32 km) 9401, brenda ambienteve të spitalit Rajonal Vlore; Brenda ambienteve të Spitalit Universitar “Shefqet Ndoroqi”, Sauk TIRANE dhe në Rr “Daullas Grecalli” nr.17, Daullas, brenda ambienteve të Spitalit Rajonal Memorial Fier; të cilat nuk rezultojnë të jenë të pajisura me licencat perkatëse për ushtrimin e aktivitetit sipas ligjit nr. 9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, neni 19”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nenligjore.*

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, per cdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqese tabelen me informacion si me poshte:

Nr.	Vendndodhja	Statusi	Nr. i regjistrit te posacem
1		<i>Pronesi/qira/perdorim</i>	
Etj.		<i>Pronesi/qira/perdorim</i>	

Detyrimisht duhet qe cdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Shënim 1.2:

Në zbatim të ndryshimeve te reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar, dokumentacion e kerkuar per cdo stabiliment (ne ponesi dhe/ose qira).

Stabilimenti/stabilimentet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Sori Al” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakti i Regjistrir Tregtar
- Deklaratë për ambientet në disponim pika 2.1, nënpika 1 me përmbajtje si vijon: Shoqëria “Sori-Al” SHPK ka në disponim ambientet sipas tabelës së mëposhtme në të cilat ushtron veprimtarinë e saj.
 1. Rruga e Dibrës, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes Tiranë (statusi me qira); LN-0308-09-2009.
 2. Brenda ambienteve të Spitalit Psikiatrik Ali Mihali Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi Vlorë, (statusi me qira); LN-2369-11-2016
 3. Spitali Rajonal Berat, (statusi me qira); LN-9898-07-2015
 4. Rruga Kongresi i Manastirit, Zona Kadastrale 8140, pallati i firmës Diagonal Projektim&Zbatim, Kati përdhe Tiranë, (statusi në pronësi); LN-2896-03-2017.
 5. Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-0308-09-2009 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë për njerëz (restorant, shërbim katering)
 6. Licencë me Kodin II.1.A (1) LN-2369-11-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë për njerëz (shërbim katering).
 7. Licencë me Kodin II.1.A LN-9898-07-2015 me emërtim përshkrues të veprimtarisë (shërbime katering).

8. Licencë me Kodin II.1.B LN-2896-03-2017, me emërtim përshkrues të veprimtarisë Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore për njerëz.

III.1.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.1.6. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit

për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.9. Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar që për çdo stabiliment që disponon (pronësi dhe/ose qira) ofertuesit duhet të paraqesin informacionin në një tabelë lidhur me vendndodhjen, statusin në pronësi/qira/përdorim, si dhe numrin e regjistrimit të posaçëm, si dhe ka kërkuar që çdo stabiliment duhet të jete i pajisur me licence përkatëse. Akoma më tej, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me ligjin do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues Sori –Al ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriter deklarata mbi ambientet në disponim. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar vendndodhjen, statusin dhe numrin e regjistrimit të posaçëm për katër ambiente/ stabilimente. KPP vëren, se ankimuesi ka paraqitur licencat përkatëse për të katër vendet e deklaruar të ushtrimit të aktivitetit me emërtim përshkrues të veprimtarisë **Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë për njerëz, si dhe shërbime katering**. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik Sori Al ShPK është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon deklaratimit të stabilimenteve që disponon të pajisura me licencat respektive. Sa i takon arsyes së skualifikimit dhënë nga autoriteti kontraktor për ankimuesin, se ky i fundit ka deklaruar vetëm 4 (katër) vende të ushtrimit të aktivitetit (stabilimente), për të cilat ka paraqitur edhe 4 licencat

përkatëse, ndërkohë që, nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar të subjektit rezulton se, ky i fundit ka 9 (nëntë) vende të ushtrimit të aktivitetit (stabilimente), KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret ka tejkaluar kërkesat në kriterin e veçantë të kualifikimit, në të cilin ka kërkuar nga ana e ofertuesve të deklarojnë stabilimentet që disponojnë dhe këto stabilimente të jenë të pajisura me licencat përkatëse, kërkesa këto të cilat referuar arsyetimit sa më sipër janë përmbushur nga ana e ankimuesit. Ndërkohë KPP gjykon, se fakti që subjekti ka deklaruar në ekstraktin e regjistrimit tregtar 9 vende të ushtrimit të aktivitetit, jo domosdoshmërisht të gjitha këto vende kanë cilësinë e stabilimenteve në të cilat kryhet veprimtaria e prodhimit, përpunimit e shpërndarjes së ushqimeve. KPP gjykon, se vetë autoriteti kontraktor nuk ka konstatuar/dokumentuar asnjë fakt, për të provuar se operatori ekonomik ushtron veprimtarinë e tij në ndonjë nga vendet e ushtrimit të aktivitetit të deklaruar në QKB, në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Referuar përcaktimeve në kriterin e veçantë të kualifikimit rezulton, se vetë autoriteti kontraktor ka parashikuar se në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me ligjin do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative, sipas nenit 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Në rastin konkret, nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kryer ndonjë hetim në drejtim të verifikimit të ushtrimit të veprimtarisë së operatorit ekonomik ankimues brenda kuadrit ligjor dhe as nuk rezulton të ketë raportuar pranë institucioneve kompetente, sikundër ka parashikuar në kriter. Në këtë kuptim arsyeja e skualifikimit për ankimuesin nuk qëndron pasi autoriteti kontraktor nuk arrin të provojë se adresat e tjera të padeklaruar nga ana e ankimuesit janë stabilimente në kuptim të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”,

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Sori Al” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sori Al” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK me argumentet se *“Referuar shtojcës 8 kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të DT kërkohet dorëzimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9. Plotësimi i kësaj shtojce nuk është bërë konform kërkesave të DT pasi nuk janë plotësuar të dhënat për të dy ortakët dhe administratorin e shoqërisë (Z.D.K dhe Z.L.Q) sipas formatit të kërkuar si dhe nuk janë deklaruar makineritë dhe mjetet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ofertuesi deklaron se:

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese

brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

III.2.2. Në shtojcën 9 “Deklarata Për Përmbushjen E Kritereve Të Përgjithshme Të Kualifikimit”, përcaktohet si më poshtë:

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: 	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]

etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.	
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të	<u>Punonjës</u> Po [] Jo []

vetme se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Nëse, po, numri i punonjësve:
	Profili i punonjësve
	<u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo []
	Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Data e dorëzimit të deklaratës _____ Vula _____ Emri, Mbiemri, Firma _____	

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik Dajti Park 2007 ShPK në përmbushje të sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcën 9 Deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit në të cilin ka deklaruar se Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: L.Q dhe D.K me të dhënat përkatëse datëlindje, atësi, amësi, vendlindje, numër personal ID nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP ose kanë qenë të dënuar dhe kanë kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.
- Deklaratë mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme të plotësuara ku ka deklaruar 34 punonjës dhe mjetet.

III.2.3. KPP gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e

vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton , se operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK ka paraqitur shtojcën 9 me emërtim “*Deklaratë Mbi Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme*”, sikundër kërkohet në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP vëren, se deklarata është plotësuar në përputhje me kërkesat e kërkuara sa i takon të dhënave lidhur me administratorin dhe ortakët e shoqërisë. Gjithashtu ankimuesi ka paraqitur deklaratën për mjetet dhe punonjësit në disponim. Në këtë kuptim, KPP gjykon se deklaratat e dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” ShPK janë të rregullta dhe përmbajnë informacionin e kërkuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sori AI” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK me argumentet se “*OE Dajti Park 2007 nuk ka deklaruar stabilimentet që disponon sipas kërkesës së seksionit 2 kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.1.kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë. Referuar Buletineve të njoftimeve publike rezulton që shoqëria Dajti Park 2007 është shpallur fituese në disa procedura prokurimi. Duke ju referuar ekstraktit të shoqërisë i vetmi vend i ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë (veç selisë) është vetëm adresa sekondare Tiranë Dajti priskë e madhe Dajti Park). Mosdeklarimi i adresave të tjera sekondare në të cilat OE ushtron aktivitet është shkelje e legjislacionit tatimor tregtar dhe ushqimor, pasi OE nuk ka deklaruar një vend të ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar. OE nuk ka deklaruar punonjësit të cilët ka vendosur në dispozicion për kryerjen e shërbimit. Nga ana tjetër mosplotësimi i këtyre kritereve ligjore të domosdoshme gjatë kryerjes së shërbimeve të marra përsipër nga OE Dajti Park 2007 passjell edhe deklaram të rremë nga ky OE lidhur me deklaratën për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim te rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Per kete arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesemarrës duhet te jete i licencuar sipas dispozitave perkatese ligjore dhe nen ligjore.*

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”, konkretisht neni 19, per cdo stabiliment qe disponon (pronesi dhe/ose qira) te paraqese tabelen me informacion si me poshte:

Nr.	Vendndodhja	Statusi	Nr. i regjistrimit te posaçëm
1		<i>Pronesi/qira/perdorim</i>	
Etj.		<i>Pronesi/qira/perdorim</i>	

Detyrimisht duhet qe çdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence perkatese. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Shënim 1.2:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin prane AK jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacion e kerkuar per çdo stabiliment (ne pronësi dhe/ose qira).

Stabilimenti/stabilimentet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik Dajti Park 2007 ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi disponimin e ambientit të gatimit me përmbajtje si vijon: Unë L.Q në cilësinë e Administratorit të operatorit ekonomik Dajti Park 2007 ShPK deklaroj, se disponoj stabiliment të pajisur me Licencën II.1.A.1 Prodhim përpunim dhe shpërndarje e ushqimeve për njerëz sipas të dhënave si më poshtë:
- Vendndodhja Priskë e Madhe; statusi në pronësi; Numri i regjistrit të posacëm....
- Licencë me kodin II.1.A (1) me emërtim përshkrues të veprimtarisë Bar Restorant dhe Shërbim Katering.

III.3.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.3.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.3.6. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.*

III.3.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.3.8. Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin

Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar, që për çdo stabiliment që disponon (pronësi dhe/ose qira) ofertuesit duhet të paraqesin informacionin në një tabelë lidhur me vendndodhjen, statusin në pronësi/qira/përdorim, si dhe numrin e regjistrimit të posaçëm, si dhe ka kërkuar që çdo stabiliment duhet të jete i pajisur me licencë përkatëse. Autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me ligjin, do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues Dajti Park 2007 ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriter, deklarata mbi disponimin e ambientit/stabilimentit. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar vendndodhjen, statusin dhe numrin e regjistrimit të posaçëm për 1 ambient/ stabiliment të pajisur me licencën përkatëse. KPP vëren se ankimuesi ka paraqitur licencën përkatëse me kodin II.1.A për vendin e deklaruar të ushtrimit të aktivitetit me emërtim përshkrues të veprimtarisë **Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë për njerëz**. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik Dajti Park 2007 ShPK është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon deklaramentit të stabilimenteve që disponon të pajisura me licencën përkatëse. Pretendimet e ankimuesit, se operatori ekonomik Dajti Park 2007 ShPK nuk ka deklaruar adresat e tjera sekondare në të cilat operatori ekonomik ushtron aktivitet në shkëlqje e legjislacionit tatimor tregtar dhe ushqimor, KPP i gjen në tejkalim të kërkesave në kriter të pabazuara në rastin konkret. Të pabazuara e gjen Komisioni, edhe pretendimin e ankimuesit se operatori ekonomik nuk ka deklaruar punonjësit të cilët ka vendosur në dispozicion për kryerjen e shërbimit, pasi nga verifikimet në SPE rezulton, se operatori ekonomik Dajti Park ShPK ka deklaruar punonjësit në shtojcën 9 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sori Al” ShPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” ShPK me argumentet se “*Operatori ekonomik Dajti Park 2007 ka dështuar në dorëzimin e plotë ligjor të dokumentacionit për të vërtetuar se disponon ambient ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit sipas kërkesave të nën pikës 2 të pikës 2.3 kapaciteti teknik të DT. OE nuk ka dorëzuar gjithashtu deklaratën për plotësimin e standardeve tekniko- teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, brenda Bashkisë në të cilin do të kryhet shërbimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

➤ **Dokumentacioni që vërteton pronësinë:**

- *Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

➤ **Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:**

- *Kontratë huaje.*

➤ **Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:**

- *Kontratë qiraje.*

Shënim 2.1: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarohet plotësimi i standardeve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit.*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Certifikatë Për Vërtetim pronësie adresa e pasurisë Priskë e Madhe, sp truall 3,250, sp ndërtesë 700.*
- *Akt Miratimi Higjeno Sanitar Nr.127*
- *Certifikatë Për sigurinë nga zjarri*
- *Licencë me kodin II.1.C*
- *Licencë me kodin II.1.A*
- *Licencë me kodin III.1.A*
- *Deklaratë për standardet teknologjike*

III.4.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.4.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- *a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- *b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- *c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

- *Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.4.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

-
- *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
- *a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- *b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- *c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- *ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- *d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.4.6. KPP gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Dajti Park” ShPK në përmbushje të kriterit lidhur me disponimin e ambientit të gatimit ka dorëzuar certifikatën e pronësisë së ambientit, si dhe deklaratën e plotësimit të standardeve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit, sikundër kërkohet në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP

gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” ShPK është në përputhje me kriterin kualifikues.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sori Al” ShPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” ShPK me argumentet se “OE Dajti park 2007 ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për secilin nga punonjësit sipas pikës 4 të kapacitetit teknik të DT **pasi nuk ka dorëzuar deklaratat e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale për drejtuesin teknik, për kuzhinierët dhe për ndihmës kuzhinierët.** Gjithashtu OE nuk ka dorëzuar deklaratën në të cilën merr përsipër që për zbatimin e kësaj kontrate stafi i paraqitur nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera deri në përfundim të kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3. 4 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të ketë jo më pak se 34 (tridhjetë e katër) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1.	Drejtues Teknik (Merceolog/Kimist/teknolog)	1
4.	Kuzhinier	7
5.	Ndihmes Kuzhinier	14
6.	Punonjes shperndares ushqimesh	8
7.	Magazininier/e	2
8.	Shofer/ Mirembajtes	2
	Total	34

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për drejtuesin teknik/(Merceolog/Kimist/teknolog) te paraqitet:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Merceolog/Kimist/Teknolog.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.
- Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet te figuroje i dypunesuar ne sektor privat apo publik. Per kete Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise te paraqes deklarate perkatese.
- Drejtuesi nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.

b) Për Kuzhinierin te paraqitet:

- Diplome ose certifikatë kualifikimi.
- Kontrate pune perkatese.
- Librezë pune

- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e – albania.

c) Për ndihmes kuzhinier të paraqitet:

- Kontrate pune.
- Librezë pune
- Duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e - albania.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi, të paraqitet:

- Kontratë pune.

e) Për punonjësit Magazinier/e, të paraqitet:

- Kontratë pune.

f) Për punonjësit shofer të paraqitet:

- Leje drejtimi mjeteve kategorisë – B.
- Kontrate pune.

- *Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:*

Nr	Emër Mbiemër	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës
----	-----------------	------------	---

Shënim 4.1: *Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe diplomat/certifikatat e çdo punonjësi pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.*

Shënim 4.2:

Me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes, për t'i dhënë mundësi çdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mesipër jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërise. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Stafi i cili do të paraqitet Autoritetit Kontraktor, për zbatimin e kësaj kontrate, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, deri në përfundim të kontratës. Për këtë arsye të paraqitet deklarata përkatëse nga Administratori/Drejtuuesi Ligjor i shoqërise.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

III.5.2. KPP gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e aseteve të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme

për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik Dajti Park 2007 ShPK, në përmbushje të kriterit lidhur me dorëzimin e deklaratës së kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania, për punonjësit në pozicionin **drejtuesin teknik/(Merceolog/Kimist/teknolog), kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier, ka paraqitur deklaratat përkatëse të** kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuara nga e – Albania për të gjithë punonjësit e kërkuar. Gjithashtu, KPP konstaton se operatori ekonomik Dajti Park 2007 ShPK në përputhje me kërkesat në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike deklaratën për stafin në të cilin deklaron, se për zbatimin e kësaj kontrate stafi i paraqitur prej tij nuk është i angazhuar në kontrata të tjera deri në përfundim të kontratës.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK, sa i takon pretendimeve lidhur me kualifikimin e tij në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-16943-01-07-2022, me objekt: “Loti I – “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”, për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond të marrëveshjes kuadër: 132,776,585 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.02.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK, sa i takon pretendimeve lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik Dajti Park 2007 ShPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Sori-Al” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sori-Al” SHPK.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri